

Tryezë diskutimi

Sfidat dhe mundësitë e Këshillave Vendore të Sigurisë Publike (KVSP)

Datë: 25 Nëntor 2021, Ora 10.00- 12.00

Formati: Hibrid

Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim (IDM) me mbështetjen financiare të Global Community Engagement and Resilience Fund (GCERF) dhe në partneritet me Qendrën e Koordinimit Kundër Ekstremizmit të Dhunshëm (CVE) janë duke zbatuar programin: "Riintegrimi i qëndrueshëm në komunitet i shtetasve shqiptarë të kthyer nga Siria". Programi zbatohet në bashkinë *Tiranë, Kavajë, Cërrik, Librazhd, Pogradec, Mat, Shkodër, dhe Kukës*.

Qeveria shqiptare përmes CVE dhe partnereve të ndryshëm të saj është duke adresuar problematikën e ri-integrimit si një prioritet të rëndësishëm duke u investuar në përgatitjen dhe ngritjen e kapaciteteve të aktoreve të ndryshëm publik dhe jo vetëm në komunitetet vendore. IDM është një nga aktoret e përfshirë në këtë proces, në këtë kuadër, ndërhyrjet në nivel komunitar i vlerëson si pjesë të rëndësishme të përgjegjësisë së institucioneve në nivel vendor. Një nga perspektivat e kësaj qasjes është përmes Këshillave Vendor të Sigurisë Publike (KVSP), të cilat po shndërrohen në një instrument të rëndësishëm shumëaktorial. Pjesa më e madhe e bashkive pjesëmarrëse në këtë aktivitet sjellin përvojat e tyre specifike lidhur me funksionimin e KVSP-ve, ndërsa disa bashki të tjera si Shkodra dhe Tirana janë në hapat e parë të ngritjes së kësaj strukture.

Përvoja e deritanishme në bashki të ndryshme të vendit ka treguar se baza rregullatore mbi të cilën mbështetet ngritja dhe funksionimi i Këshillave Vendor të Sigurisë është e ndryshme. Këto ndryshime prekin objektivat dhe strukturën organizative, proceset konsultuese dhe vendimmarrëse, nivelin e përfshirjes qytetare, rolin e institucioneve të ndryshme në këtë proces. Të gjithë këto ndryshime së bashku me një proces dinamik konsultimi dhe llogaridhënie me qytetarët ndikojnë në qëndrueshmërinë dhe efektivitetin e punës së Këshillave Vendore të Sigurisë Publike.

Ndërkohë, gjatë 2-3 viteve të fundit, IDM ka iniciuar një model më gjithëpërfshirës të luftës dhe parandalimit të krimit në nivel vendor i cili mbështetet në ndërveprimin midis bashkisë, policisë dhe prokurorisë i cili mbështetet në një model ciklik të ndërveprimit dhe përgjegjshmërisë publike. Në këtë kuadër, IDM po përcjell një draft rregullorë për KVSP¹ që merr parasysh përvojën dhe sfidat në vazhdimësi në raport me sigurinë publike.

Një qasje shumëaktoriale vendore do të ishte një mekanizëm efektiv në përballjen jo vetëm me kërcënimet tradicionale që kanë të bëjnë me zbatimin e ligjit, integritetin e pronës dhe të individit, luftën kundër mbjellës dhe përdorimit të bimëve narkotike, dhuna në familje apo edhe më tej sfida të karakterit ekonomik, social dhe zhvillimor. Po kështu, do të ishte mekanizmi i duhur për kohezionin social, integrimin, përballjen me flukse migratore dhe riintegrimin në shoqëri të

¹ Për bashkinë Tiranë, IDM në bashkëpunim me përfaqësues nga bashkia Tiranë mund të hartojë një draft rregullorë për kontekstin e Tiranës.

azilkërkueseve dhe refugjatëve që iu largohen konflikteve të armatosura në vendet e tyre të origjinës.

Në këtë kuadër, Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim (IDM) do të zhvillojë një tryezë diskutimi për sfidat dhe mundësitë e Këshillave Vendore të Sigurisë Publike (KVSP). IDM do të prezantojë një draft rregullorë për funksionimin e KVSP-ve dhe përfaqësues të lartë nga Bashkia Elbasan do të ndajnë përvojën e tyre.

Aktiviteti do të zhvillohet në datën **25 Nëntor, ora 10:00-12:00**, në ambientet e Hotel Tirana International dhe online përmes platformës Zoom. Jeni të lutur të shprehni interesin tuaj për pjesëmarrje në: abruci@idmalbania.org, para datës **18 nëntor 2021**.

Axhenda:

Ora	Tematika
10:00 – 10:20	Hapja e takimit & fjalë përshëndetëse - Z. Sotirag Hroni, Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim (IDM) - Znj. Lejdi Dervishi, Qendra Kundër Ekstremizmit të Dhunshëm (CVE) - Z. Saimir Plaku, Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore - Përfaqësues i lartë i Prokurorisë - Përfaqësues i lartë i Policisë së Shtetit
10:20 – 10:45	Ndarja e përvojës nga institucionet vendore (bashkia, polici, prokurori) Përfaqësues të lartë të institucioneve vendore
10:45 – 11:00	Prezantimi i një draft rregullorëje për funksionimin e KVSP-ve Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim (IDM)
11:00 – 11:10	Koment mbi draft rregulloren dhe përvojën e bashkisë Elbasan në hartimin e plan veprimit Z. Ervin Muço, Bashkia Elbasan
11:10 – 11:45	Pyetje dhe diskutime
11.45 – 12:00	Mbyllja e takimit Qendra Kundër Ekstremizmit të Dhunshëm (CVE) Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim (IDM)